REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery	14. 09 201	8	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5331/2018		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.460/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Hajzer Salihu-kryetar, Lela Petkoviç dhe Shkëmb Manaj-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-procesmbajtës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.460/2018 të datës 19.07.2018 të parashtruar nga ankuesi Jahir Zuka me banim në fshatin Lloshkobare në Komunën e Ferizajt, kundër Vendimit me Nr. 02-070/01-0056589/18 të datës 18.06.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagraftin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagraftin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.460/2018 e datës 19.07.2018 e parashtruar nga ankuesi Jahir Zuka.

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 02-070/01-0056589/18 i datës 18.06.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, dhe Formulari për paralajmërimin (qortimi) me shkrim i datës 17.05.2018 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit 15 ditorë nga dita e pranimit të tij, duke e hequr paralajmërimin (qortimin) me shkrim nga dosja e personale e ankuesit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi Jahir Zuka, i punësuar sipas ndryshim dhe plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 18.08.2016 në pozitën "Udhëheqës i Zyrës Ligjore" në Komunën e Ferizajt, më datë 08.05.2018 ka marr ftesë për takimin e tretë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor i cili takim është mbajtur më datë 15.05.2018 në Restaurant "VIGU" në Koshtovë-Mitrovicë, në të cilin takim ka marrë pjesë edhe

ankuesi. Kryetari i Komunës së Ferizajt më datë 17.05.2018 ankuesit i ka shqiptuar masë disiplinore ***"Paralajmërim (qortim) me shkrim"***, duke theksuar që një kopje e këtij paralajmërim të vendoset në dosjen personale konfidenciale.

Ankuesi i pakënaqur me masën e shqiptuar më datë 01.06.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Ferizajt. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Ferizajt më datën 18.06.2018 ka nxjerr Vendimin me Nr. 02-070/01-0056589/18 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi masën e shqiptuar ndaj tij.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr. 02-070/01-0056589/18 të datës 18.06.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, brenda afatit ligjor konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 17.07.2018 nëpërmjet Postës parashtron ankesën për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 19.07.2018 dhe është protokolluar me numër protokolli 4166/2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 23.07.2018 tek Komuna e Ferizajt ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit. Me datë 07.08.2018, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Ferizajt me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Administrimi i provave: Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokolli 4266/2018 të datës 19.07.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-070/01-0056589/18 të datës 18.06.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt; Formularin për paralajmërim me shkrim i datës 17.05.2018; Ftesën për takimin e tretë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor e datës 08.05.2018; Urdhëresë për shfrytëzimin e automjetit zyrtarë datë 15.05.2018; Zarfin e Postës i datës 17.07.2018; Ankesën e datës 01.06.2108 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe përgjigjen në ankesë e datës 07.08.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Jahir Zuka, **është e bazuar, sepse**:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore ***"paralajmërimi (qortimit) me shkrim"***, e cila nuk është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore ne Shërbimin Civil, sepse në dispozitat ligjore të nenit 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 7 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore ne Shërbimin Civil, nuk është përcaktuar ndonjë masë e tillë por është përcaktuar vetëm "paralajmërim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ndaj nëpunësve civil duhet të shqiptohen vetëm ato masa që janë të përcaktuar me legjislacionin për shërbimin civil dhe të cilat janë në kompetencë të udhëheqësit të

drejtpërdrejtë të nëpunësit civil, në këtë kuptim Kryetari i Komunës së Ferizajt është i obliguar që masën e shqiptuar ndaj ankuesi ta bëjë ne pajtim me dispozitat ligjore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Ferizajt, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 02-070/01-0056589/18 të datës 18.06.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që të konstatojë drejtë gjendjen faktike dhe juridike mbi masën e shqiptuar, e po ashtu po ashtu ky komision në preambulën e vendimit ka përdorur Udhëzimin Administrativ Nr. 2003/05 të MSHP/DASHC-it, udhëzim ky i cili është shfuqizuar dhe tani ne fuqi per procedurat e ankesave është Rregullorja Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Jahir Zuka;
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.460/2018.

Hajzer SALIHU
Kryetar i Kolegjit

Avdyl BEKTESHI
Procesmbajtës